

NASHO JORGAQI**RRËFIMTARI I MADH MITRUSH KUTELI***

Në jetën e çdo letërsie, midis punëtorëve të fjalës, dallohen mjeshtrit e saj. Mund të themi pa mëdyshje se Mitrush Kuteli është një mjeshtrë i madh i fjalës shqipe. Me forcën dhe bukurinë e kësaj fjale, ai ngriti veprën e tij artistike dhe u bë një nga individualitetet më të spikatura të letërsisë shqiptare. Në personalitetin krijues të M. Kutelit bashkohen prozatori me poetin, përkthyesi me kritikun letrar, përrallëtari me folkloristin, publicisti me studiuesin e shkencave ekonomike e mbi të gjitha mjeshtri i tregimit. Duke derdhur forcat kryesore krijuese në lëmin e prozës tregimtare, Kuteli dha në këtë gjini një ndihmesë shumë të çmuar dhe bëri emër të veçantë po të kemi parasysh peshën e prozës si tregues i pjekurisë së një letërsie.

Dihet se prozës shqiptare i është dashur fillimisht të ndjekë një rrugë të vështirë, me zigzage e ritme të ngadalshme. E lindur në një terren letrar poetik, me një traditë të varfër të llojit të vet, ajo, edhe gjatë Rilindjes, nuk e kapërceu nivelin e një proze didaskalike-moralizuese. Vetëm pas Pavarësisë, në kushtet e reja shoqërore-historike, në marginat e prozës sonë do të zhvillohen procese të brendshme e do të shprehen dukuri që do ta ndryshojnë fizionominë e saj të përgjithshme. Në këto procese progresive duhet të veçojmë dy momentet më të rëndësishme: lindjen e romanit shqiptar në fillim të shekullit XX dhe kthesën që bëri proza e shkurtër, me ngritjen cilësore që shënoi tregimi në vitet 20-30 të atij shekulli. Me këtë të fundit lidhet emri i Kutelit në historinë e letërsisë sonë të traditës. Ai është ndër ata autorë të paktë që u angazhua e punoi drejtpërdrejt e me sukses për kapërcimin e prapambetjes së tregimit shqiptar.

Në kapërcyell të viteve 20-30, proza jonë, duke ndjekur traditën e shëndoshë tematike të letërsisë së Rilindjes, do të bënte që brenda hapësirave të saj të hynte fryma dhe problemet e mprehta bashkëkohore. Rritja e zhvillimi i shoqërisë shqiptare, përpjekjet e forcave përparimtare për emancipimin e saj, kërkonin dhe zgjerimin e kufijve të pasqyrimit të jetës në letërsi. Poezia, me gjithë nivelin e lartë dhe aftësitë pasqyruese e

* Pjesë e shkëputur nga monografia e pabotuar me të njëjtin titull.

përgjithësuese, nuk arrinte, për vetë specifikën e saj, ta jepte realitetin shqiptar në gjerësinë dhe thellësinë që lypte koha. Kjo detyrë i takonte prozës, si gjinia letrare e përmasave e përgjithësimeve të mëdha. Po a ishte ajo në gjendje me nivelin që kish ta bënte këtë? E vërteta është se që të arrihej kjo, proza duhej që të fitonte pjekuri, në radhë të parë pjekuri tematike, rrokje të gjerë të jetës shqiptare, trajtim bashkëkohor të problemeve themelore, po më shumë lypte nivel artistik, të cilin e kishte në shkallë të pamjaftueshme. Në qoftë se tematika sa vinte e zgjerohej dhe po pasurohej, nga pikëpamja artistike, ajo nuk e kish gjetur veten plotësisht. Proza jonë qëndronte akoma nën hijen e poezisë, duke huazuar e shfrytëzuar mjete shprehëse e forma të saj, siç do t'i paguante haraç dhe prozës publicistike e dokumentare. Prandaj ajo do të vihej në kërkim të vetvetes, duke dalë nga monopetet e ngushta të prozës së traditës, do të luftonte për një shprehje adekuate artistike, me mjetet dhe format e veta pasqyruese e tipizuese. Kualifikimi artistik i prozës nuk do të ishte diçka në vetvete, një proces i mbyllur, po kjo do të arrihej, në radhë të parë, në lidhje të gjithëmbarshme me realitetin e gjallë, me problemet, me njeriun shqiptar dhe mjedisin e tij. Për këtë ajo duhej të largohej nga pasqyrimi i thjeshtësuar i realitetit, i përshkrimit kronikal e linear të ngjarjeve e situatave, i paraqitjes konvencionale të figurave, i një gjuhe uniforme e patetike. Gjithë përpjekjet do të synonin drejt mishërimit artistik të realitetit e krijimit të karaktereve, tipizimit dhe zbulimit të tyre përmes një procedimi e shkallëzimi artistik. Nga ana tjetër, ajo duhej të gjente struktura kompozicionale, të arrinte te dialogu e monologu karakterizues, në faktura të mirëfillta narrative, në një gjuhë emocionale e me vlera ideoartistike; me fjalë të tjera, të shkohej drejt zotërimit të artit të prozës, të arriheshin nivelet e parametrat e poezisë shqiptare, e cila kish krijuar modele madhore.

Natyrisht, pjekuria e prozës nuk mund të sigurohej menjëherë, jo vetëm se lypte kohë, po varej dhe nga faktorë objektivë, letrarë e jashtë-letrarë, se, tek e fundit, kish të bënte me rrugën e secilit individualitet në këtë fushë të letërsisë. Prandaj dhe frytet e prozës sonë do t'i shohim nga fundi i dekadës së dytë dhe mesi i së tretës. Atëherë do të dalin dhe prozatorët e vërtetë, me tërë atributet artistike, mjeshtrit e epikës tregimtare si, M. Kuteli, E. Koliqi, Migjeni, N. Bulka etj. Secili do të ketë profilin e tij, që do të varej nga përvoja jetësore dhe natyra artistike, nga konceptet dhe formimi ideoestetik, nga mjedisi dhe pozita shoqërore.

Krijimi i fizionomisë së prozës sonë, lëvrimi i formave të saj, konsolidimi i mjeteve shprehëse ndoqi rrugë të ndryshme dhe nuk ishte i

barabartë për të gjitha individualitetet krijuese. Në rast se proza e Migjenit karakterizohet nga një frymë novatore si në konceptimin e jetës dhe këndvështrimet e reja, ashtu dhe me shkallën e lartë të kritikës sociale, këtë nuk mund ta themi për të tjerë. Proza e E. Koliqit, ishte antipod filozofiko-shoqëror i asaj të Migjenit, qe ndërtuar disa herë sipas modeleve të prozës së huaj, duke pasur parasysh temat frojdiste, veçanërisht ato të G. D'Anuncios me shokë. Mitrush Kuteli nuk u tregua novator në shkallën e Migjenit dhe as u mbështet në modele të huaja si Koliqi, ai e ngriti prozën e vet mbi bazën kombëtare, iu drejtua frymës dhe fakturave të rrëfimit popullor. Nga kjo pikëpamje, ajo, në kohën e saj, i kundërvihej atmosferës dhe prirjeve kozmopolite të asaj pjese të inteligjencies, të cilat, ose e mohonin karakterin kombëtar dhe frymën popullore, ose i imitonin ato formalisht.

Mitrush Kuteli, duke hyrë në letërsinë shqiptare gjatë kthesës që ndodhi në prozën tonë, duke sjellë ndihmesën e tij të ndjeshme në ngritjen e nivelit dhe kualifikimit të saj artistik, u bë një nga krijuesit e tregimit modern shqiptar. Në këtë terren të vështirë, ai punoi gati tërë jetën, ndonëse me intervale, duke dhënë disa vëllime me vlera të spikatura. Në qoftë se tregimet e para ("*Netë shqiptare*") ishin "vepra djalërie", siç i quan vetë, të tjerat u shkruan në një moshë përfaqësisht të pjekur e me përvojë krijuese, për t'u ngritur në nivelin më të lartë të prozës narrative që shkroi mjeshtri ynë.

Mitrush Kuteli krijoi rreth tridhjetë tregime, të cilat ai i quan zakonisht rrëfime, ndërsa një pjesë i cilëson rrëfenja. Me këto, autori i tyre e pasuroi prozën e shkurtër shqiptare me një tip të veçantë tregimi, që jo vetëm ishte një lloj i ri letrar, por me arritjet e tij më të mira, Kuteli përuroi një shkollë të vetën të tregimit tonë. Tregimi kutelian, siç do ta analizojmë më tej, është ngritur ose shartuar kryesisht mbi trungun e rrëfimit popullor shqiptar. Ndarja e tyre në rrëfime e rrëfenja është përcaktuar sa nga tematika, aq edhe nga fryma që ngërthejnë. Në qoftë se në të parat zotërojnë tema patriotike-sociale, në të dytat trajtohen motive folklorike-mitologjike.

Duke i analizuar nga afër tregimet e Kutelit shohim se në to është pasqyruar dhe gjallëron bota autoktonë shqiptare. Është ky një univers i tërë, i përfutur nga njohja dhe përjetimi i thellë i historisë dhe jetës shoqërore e zakonore të vendlindjes, nga evokimi i kujtimeve të fëmijërisë, nga lidhjet shpirtërore me traditat dhe thesaret shpirtërore të popullit, nga dashuria e venerimi i thellë që ka për fjalën shqipe. Proza e tij bëhet akoma më e afërt për lexuesin, se ajo ka adresë gjeografike e

kohore të përcaktuar mirë dhe kjo na lejon t'i vendosim qartë kufijtë e realitetit artistik që ai krijon. Siç është thënë me të drejtë¹, amfiteatri ku zhvillohen ngjarjet dhe vepronë heronjtë e rrëfimeve të Kutelit janë zakonisht trevat e vendlindjes, që shtrihen nga Guri i Kuq deri te Guri i Prerë, janë hapësirat plot dritë e ngjyra të Pogradecit dhe viset e ashpra të malësive të Mokrës. Që në rrëfimet e para, autori e çon lexuesin në Katjelë, nën brigjet e Mokrës dhe në Peshkëpi, nën Malin e Thatë për të vazhduar më tej si një rregull të paprekur në Tushemisht e në Grykën e Rrëmenjit, pa u larguar asnjëherë nga ujërat e liqenit. Në këtë sfond piktoresk, epik e lirik, të vizatuar me hijeshi dhe saktësi, ndizet e lëviz jeta shqiptare nga penda e Kutelit. Është e njëjta trevë që gjejmë dhe në poezinë e Lasgushit, por në qoftë se poeti i këndoi, prozatori e përshkroi në përmasa të gjera.

Vështruar në rrafsh kohor, rrëfimet e Kutelit kanë për brendi kryesisht të kaluarën, epoka të afërta e të largëta, historinë e gdhendur në kujtesën e popullit, të cilën autori e gjurmon, e qartëson, e interpreton dhe e përshkruan. Ajo vjen nga mitologjia, përmes qeniesh e bëmesh të jashtëzakonshme, si pjesë e mjegulluar e historisë dhe shpaloset në ngjarje e figura të qarta, flet për kohën e Skënderbeut dhe të Bendo Shapërdanit, përshkruan epokën e madhe të Rilindjes, evokon ndodhi të luftërave ballkanike e asaj botërore dhe ndalet në kufijtë midis dy kohërave, kur mbyllen përpjekjet për një Shqipëri të lirë dhe nis zhgënjimi i popullit dhe urrejtja e tij ndaj pushtetit të bejlerëve. Edhe kur merr ngjarje që e kapërcejnë këtë kufi, ato tregohen më shumë si ndodhi të së kaluarës.

E kaluara në tregimet e Kutelit është realiteti pothuaj i vetëm me të cilin autori operon. Një realitet jo i mbyllur e i marrë në vetvete, në rastet më të mira ai jepet në lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me kohën. Distancimi kohor te Kuteli merr funksione të caktuara ideo-artistike: ai projektton të kaluarën me synime bashkëkohore dhe kjo bën që, objektivisht, të shquhen diferencat në mes epokave e të nënvizohen ide të rëndësishme aktuale.

Po të parafrazonim një mendim të Ismail Kadaresë, se në rrëfimet e Kutelit është përshkruar "Shqipëria e përjetshme" që s'kishte asgjë të përbashkët me Shqipërinë zyrtare, me mbretërinë e përkohshme të

¹ Mirosh Markaj. *Vende dhe njerëz në veprën e M. Kutelit*, Kumtesë mbajtur në sesionin shkencor kushtuar 80-vjetorit të M. Kutelit. Pogradec, tetor 1987.

Zogut², do të thoshim se Kuteli, duke bërë këtë, arrin të krijojë vizionin autentik të botës shqiptare, jetën e popullit dhe trojet e tij të përhershme. Edhe pse kjo botë shqiptare duket disi e largët dhe, për pasojë, siç thotë Kadareja “mospërfillëse dhe e mënjanuar nga tallazet politike”, objekti-visht brenda saj vlon jeta e popullit e, veçanërisht, jeta e fshatarësisë, vepronë konflikte të ashpra e të fuqishme, ndizen pasione tronditëse, shtrohen probleme e nxirren mësim nga historia. Duke arritur të bëjë këtë në rrëfimet madhore, Kuteli i flet kohës së tij në mënyrën e vet dhe hyn në dialog me të. Në këtë pikëpamje, ky nuk ishte vetëm një ballafaqim tërësor në mes së kaluarës e së tashmes, por dhe një rrezonim idesh, konceptesh e mendimesh midis epokash të ndryshme.

Por, te rrëfimet e Kutelit, megjithëse e kaluara dhe e sotmja konceptohen si kategori historike dhe, e para nuk shkëputet nga e dyta, prapë ndeshemi herë-herë me një frymë ekzaltimi pas së kaluarës, me një lloj magjepsjeje ndaj njerëzve dhe bëmave të tyre për të cilat flet historia e gojëdhënat. Ai është aq i pakënaqur nga aktualiteti bashkëkohor, sa shëmbëlltyrat e vërteta të patriotizmit e të vlerave shpirtërore, të burrërisë e urtësisë, të pastërtisë morale, i gjen kryesisht në kohë të kaluara.

Në qendër të prozës rrëfimtare të Kutelit është fshatarësia shqiptare, qëndresa e saj për ekzistencë, lufta për liri dhe për tokë. Kjo ka bërë që autori ta vështrojë e përshkruajë fshatin shqiptar, jo si një vend të qetë e një bashkësi me interesa të harmonizuara, po si arenë luftërash liridashëse e ndeshjesh klasore. Në këtë konceptim historik nuk e ka çuar shkrimtarin ndonjë tezë filozofike sociale, por vetë jeta, njohja intuitive dhe përjetimi i saj i thellë, ballafaqimi me situatën tronditëse të kohës, të mëkuarit që në fëmijëri me realitetin e gjithëmbarshtëm fshatar. Nga ana tjetër, kultura dhe aftësitë e shquara prej ekonomisti e mprehën dhe e bënë më analitik vështrimin e tij. Jeta shqiptare, e sidomos ajo e fshatit, do të kalonte nëpër spektrin e diferencimit klasor, po dallimet do t'i shihte jo aq në pozitën e vështirë ekonomike dhe në shpërndarjen e padrejtë të të mirave materiale, sesa në shtypjen dhe dhunën që i bëhej fshatarësisë, në zemërimin dhe revoltën e saj ndaj bejlerëve. Të gjitha këto, autori ua jep lexuesve përmes evokimit të së kaluarës, të gojëdhënave popullore, të rrëfimeve ngjethëse të pleqve, të përtëritjes së kujtimeve të fëmijërisë. Reagimi dhe qëndrimi i tij ndaj këtij realiteti në retrospektivën që shpalos me vërtetësi, guxim e dhimbje, është ai i një

² I. Kadare, *Parathënia*, Vepra e Migjenit, Tiranë, 1980.

shkrimtari të mbujtur me frymën e Rilindjes dhe idealet demokratike. Kuteli, në këtë vështrim, vihet në rolin e një dëshmitari e përshkruesi që ka marrë anën e fshatarësisë e të vegjëlisë në përgjithësi, që nuk pajtohet me shtypjen e padrejtësitë e kohës. Një gjë të tillë shkrimtari ynë e paraqet kryesisht përmes aktesh individuale dhe ngjarjesh që lidhen me fate vetjake. Mungojnë në veprën e tij momente të lëvizjeve fshatare, si shfaqje masive të luftës e të urrejtjes popullore kundër shtypjes e padrejtësive. Fshatari është dhënë shpesh herë si individ më tepër i vetmuar, në kontekstin social-historik të jetës patriarkale e të shoqërisë feudale. Problemet që e kanë shqetësuar Mitrush Kutelin dhe i ka bërë objekt në rrëfimet e veta, janë ato që lidhen me gjendjen shoqërore dhe ekonomike të fshatarësisë shqiptare. Është fjala për disa nga plagët e rënda të jetës së saj, si kurbeti e hakmarrja, mercenarizmi dhe përçarja, arbitrariteti klasor. Të dhëna këto si ngjarje të ndodhura në të kaluarën e largët e të afërt, disa prej tyre ishin dhe ngjarje që kishin rrethana shoqërore të përbashkëta me aktualitetin e periudhës së Pavarësisë. Në qoftë se mercenarizmi dhe përçarja nuk vepronin më si fenomene të kohës, kurbeti dhe hakmarrja, padrejtësitë në kurriz të fshatarësisë qenë një realitet i ditës.

Kurbeti në rrëfimet e Kutelit jepet jo vetëm si një e keqe e madhe shoqërore që shkreton fshatin shqiptar, por edhe si një dramë në jetën e vështirë të fshatarit. Mbi këtë dramë është ngritur rrëfimi "*Xha Brahua i Shkumbanores*". Pasojat e kësaj drame hedhin hijen e tyre të rëndë dhe në lodrat e ëndrrat e pastra të fëmijëve, siç ndodh në rrëfimin "*Vendosa të shkoj në mërgim*". Në një dimension tjetër është dhënë kurbeti te rrëfimi "*Natë qershori*", ku tregohet për jetën e vështirë të punëtorëve emigrantë dhe lidhjet shpirtërore që mbajnë me atdheun. Vizioni i atdheut silltet i gjallë në tregim, sa nëpërmjet kujtimeve të vendlindjes, aq dhe të rrëfimeve të moçme për trimërinë fshatare kundër bejlerëve.

Më gjerë dhe me forcë më përgjithësuese ka dalë në rrëfimet e Kutelit zakoni i egër i hakmarrjes, zakoni ky që paraqitet si pjellë e normave patriarkale dhe e politikës përçarëse të pushtuesve e të bejlerëve. Lufta vëllavrasëse në mes dy fiseve, Gjonomadheve e Gjatollinjve ("*Gjonomadhë e Gjatollinjë*") është e përshkruar aq e egër dhe e pamëshirshme, sa tingëllon si një legjendë tronditëse. Guximi i çartur i fshatarëve, karakteri dhe pasionet e tyre të fuqishme bëhen pre të një zakoni gati atavik, siç është hakmarrja.

Zakoni i hakmarrjes dhe i mercenarizmit janë parë nga Kuteli si shfaqje të të njëjtit fenomen dhe të kushteve të përbashkëta shoqërore.

Ishin varfëria dhe nevojat ekonomike, padituria dhe dasitë, ato që ushqenin dhe nxisnin mercenarizmin në jetën e fshatarësisë sonë. Fati tragjik i Gurit dhe i Xhezairit, të cilët duke luftuar për interesa të huaja kuptojnë më në fund absurditetin e veprimeve të tyre, përbëjnë dramën e rrëfimit “*Më kot*”. Evoluimi i mendimeve dhe i qëndrimit të heronjve, kthesa që ata bëjnë, realizohet nëpërmjet situatash të përligjura dhe motivesh bindëse nga ana psikologjike. I përafërt me këtë rrëfim, për nga idetë dhe koha kur zhvillohen ngjarjet, paraqitet dhe rrëfimi “*Natë prilli*”. Ai është ndërtuar mbi një varg ndodhish trimërore, që rrëfohen nga Destani, një malësor nga Mokra i porsakthyer nga lufta. Tregimi tingëllon si një mallkim për gjakderdhjen e pakuptimtë të luftërave të padrejta dhe pasojave tragjike në jetën e fshatarëve të thjeshtë, po dhe si një baladë mbi trimërinë e shqiptarit, të trashëguar brez pas brezi. Kuvendet dhe rrëfimet e burrave, aktet dhe psikologjia e tyre jepen me nota epike. Autori, herë-herë, nuk arrin të distancohet nga përshkrimet entuziaste të bëmave shqiptare. Për të fshatari e në përgjithësi burri shqiptar nuk mund të merret me mend pa trimëri, pa akte guximtare. Janë këto që i japin kuptim ekzistencës dhe pozitës së tij në shoqërinë e kohës.

Vend të rëndësishëm zë në rrëfimet e Kutelit tema antif feudale. Në letërsinë tonë të traditës asnjë prozator tjetër nuk e trajtoi këtë temë me aq thellësi e mjeshtëri si Kuteli. Në rast se nga shkrimtarë të tjerë të kohës, ky aspekt i shoqërisë shqiptare u kap dhe u pasqyrua në mënyrë anësore e të sipërfaqshme, ose u dha fshati përmes skenash ngjethëse e fshatarët si viktima të mjerimit, siç bëri Migjeni me skicat letrare, Kuteli ka meritën që ta ketë përshkruar ballazi klasën feudale, si një forcë regresive e të zvetënuar shpirtërisht, që shtyp popullin, si klasë që ka tradhtuar interesat e atdheut dhe është bërë vegël e pushtuesve. Edhe në konceptimin e trajtimin e kësaj teme ai është nisur nga burimet popullore, nga kronikat e pashkruara të kujtesë së fshatarësisë, nga njerëz dhe ngjarje, që i ka njohur dhe përjetuar në vendlindje, në Pogradec e në Mokër. Mbi bazën e këtyre burimeve të gjalla kanë lindur rrëfimet tronditëse për bejlerët dhe zullumet e tyre.

Duke dhënë formalisht në retrospektivë padrejtësitë dhe shtypjen feudale si fenomene që zhvillohen në të kaluarën, kufijtë e së kaluarës me të sotmen bëhen të përbashkët, po të mbajmë parasysh se sado ndryshime të kenë ndodhur, thelbi shoqëror dhe ekonomik i klasës feudale dhe pasojat e saj në jetën e fshatarit nuk kishin ndryshuar. Mjafton të themi se argumenti më bindës dhe shembujt më të gjallë ia jepte autorit realiteti bashkëkohor i fshatit shqiptar, siç qenë dëbimi me forcë i fshatarëve të

Goricës nga tokat e tyre, ose konflikti i ashpër i fshatarëve të Peshkëpisë me Istref beun.

Mitrush Kuteli në rrëfimet me temë antifeudale nuk bën histori e as jep kronika ndodhish të ngjara: ai synon të përgjithësojë e të arrijë në tipizimin e fenomenit nëpërmjet karaktereve dhe situatave sa më domethënëse. Feudalët, bejlerët dhe agallarët e Kutelit janë figura përgjithësuese të armiqve të popullit, si shtypës dhe dhunues të fshatarësisë, shpërdorues të pushtetit. Ata dalin uzurpatorë, tiranë e dinakë, të zhveshur nga virtytet e bartës vesesh të ulëta. Kjo është një vijë konstante që ndjek autori në paraqitjen e tyre, nga kohët më të hershme të anarkisë feudale (“*Natë kollozhegu*”) e deri në kohët më të reja. (“*Vjeshta e Xheladin beut*”).

Ndoshta asnjë figurë tjetër nuk e ka mishëruar aq mirë në një kontekst shoqëror-psikologjik tipin e beut sa ajo e Olloman beut te “*Natë kollozhegu*”. Nëpërmjet një rrëfimi të moçëm që tregon malësori plak, xha Martini, zbulohet i shkallëzuar psikologjikisht dhe i nuancuar artistikisht, duke kaluar nga një situatë në tjetrën, tirania e një beu tipik, natyra e tij prej shtypësi e shfrytëzuesi, cinizmi e dinakëria, tradhtia ndaj atdheut. Por ky realitet do të ishte i njëanshëm në rast se autori nuk do t’i kishte kundërvënë figurës së beut figurën antagoniste të fshatarit trim e të paepur, siç është ajo e Malush Katundishtit. Qëndresa e tij dhe e fshatarëve përshkruhen si kundërveprim i fuqishëm ndaj padrejtësisë e tiranisë dhe në qoftë se ata marrin një goditje të rëndë me vrasjen e Malushit, autori nënvizon idenë se tharmi i luftës dhe i urrejtjes ndaj bejlerëve rron në shpirtin e popullit.

Jo rastësisht rrëfimin për zullumet e Kareman beut në tregimin “*Natë muaji Shembitër*” e bën Argjir Vlonjati, një luftëtar i epopesë së Vlorës. Gjithë historia që shpalos para lexuesit është një zinxhir ndodhish për të këqijat sociale dhe kombëtare të bejlerëve, si shkaktarë të kurbetit të fshatarëve e të mjerimit të tyre, si dhunues dhe shkelës të ndjenjave të të rinjve. Prandaj dhe hakmarrja kundër tij vjen në rrëfim si rezultat logjik i mbrojtjes së dinjitetit njerëzor dhe i nderit shqiptar. “Ku ka be ... ik një sahat e më parë ...” – ky është lajtmotivi i tregimit.

Përgjithësimi shoqëror dhe mishërimi ideoartistik i temës antifeudale në prozën e Kutelit arrin kulmin e vet në rrëfimin “*Vjeshta e Xheladin beut*”. Megjithëse në të zotëron plani etiko-intim dhe figura e beut është lokalizuar në rrethin familjar, kjo nuk e pengon që të ndihet sfondi shoqëror e historik. Pozicioni i prerë i autorit dhe vizatimi realist i marrëdhënieve shoqërore në rrëfim janë harmonizuar me thurjen e

goditur të subjektivit, me rrjedhën e natyrshme të situatave, me këndvështrimin origjinal të dhënies së ngjarjeve. Rrëfimi arrin të përftojë një sintezë të vërtetë artistike mbi një fenomen regresiv të jetës shqiptare, siç është ai i degjenerimit të klasës feudale. Duke pasur një adresë të qartë historike dhe sociale, Xheladin beu është beu tipik shqiptar me thelbin e vet shoqëror, me biografinë politike të një mohuesi të atdheut dhe tradhtari të kombit, po dhe të një shfrytëzuesi të paskrupull të popullit.

I vendosur në çifligun e vet, në marrëdhënie brenda dhe jashtë mjedisit, fokusi i shkrimtarit realist arrin të nxjerrë në dritën e së vërtetës karakterin dhe tipin e tij shoqëror. I pashpirt dhe egoist, njeri me koncepte orientale e anakronike, me botën e ngushtë e të varfër prej turçeliu parazit e vulgar, rob i epsheve dhe i pangopësisë, Xheladin beu është mishërim i klasës së tij. Veçanërisht ai del mjaft i qartë në marrëdhëniet me Marën, që përbën dhe nyjen e tregimit. Momenti kur zbulon që e bija e Marës është bija e tij, me të cilën ai do të përsëritë lidhjet që ka pasur me të ëmën, krijon një tension dramatik aq të fortë, sa e çon Xheladin beun në çmenduri. Një akt i tillë duket befasues për klasën e tij, që ka humbur shumë nga natyra njerëzore, por në rastin konkret, falë aftësisë së autorit, ai përlligjet dhe tingëllon bindës. Ndoshta, një zgjidhje tjetër do ta nxirrte Xheladin beun më tepër një tip patologjik, që do ta kufizonte së tepërmi kuptimin shoqëror të figurës. Rëndësi të veçantë në tregim merr Mara, si figurë antagoniste, me peshën më të madhe ideoemocionale. Është kjo grua e thjeshtë, që me karakterin e vlerat e saj shpirtërore, me kurajo dhe këmbëngulje të paepur e mbërthen Xheladin beun në gozhdat e turpit dhe i jep dënimin e merituar. Gjithë rrëfimi përshkohet nga mendimi se njerëz si Xheladin beu dhe klasa e tij vijnë e shkojnë, kurse populli mbetet.

Temës antifeudale i takon dhe rrëfimi "*Lumi i madh*". Edhe pse vendin kryesor e zë përshkrimi i dëmeve e pasojave të këqija që sjell vërshimi i lumit në jetën e fshatarëve, tregimi është plot elemente sociale dhe detaje realiste. Etja për tokë, dëshira për ta fituar atë nga dy brigjet e lumit jepet e diferencuar. Fshatarët luftojnë për tokën nga nevoja për ekzistencë, kurse beu, akaparuesi më i madh, e bën këtë nga babëzitja dhe lakmia e pangopur. Është kjo lakmi, që lumi shkaktonte dëme aq të mëdha. Subjekti fare i thjeshtë i tregimit nuk e pengon autorin, që e njeh aq mirë jetën e fshatit dhe natyrën shqiptare, të rikrijojë skena të gjalla e plot detaje, atmosferë dhe kontraste, këndvështrime origjinale, gjithnjë me një nëntekst të qartë social.

Realiteti historik dhe shoqëror i fshatit shqiptar të rrëfimet e Kutelit nuk mund të merret me mend pa figurën e kaçakut. Kjo ka të bëjë me një fenomen të njohur social e politik, të përhapur në vendin tonë gjatë pushtimit osman dhe më pas. Ajo përfshinte, në radhë të parë, fshatarësinë, por dhe elementë të vegjëlisë qytetare, që ngrinin krye kundër robërisë së huaj dhe padrejtësive e terrorit feudal. Me këto lidhen sa e sa ngjarje e akte trimërie, për të cilat populli nuk reshtte së treguari. Pas këtyre figurave legjendare, Kuteli do të magjepsej dhe do t'i rikrijonte në rrëfimet e tij. Një pasqyrim realist e zbërthim psikologjik mjaft të goditur ka gjetur kjo temë në rrëfimin "*Si u takua Ndoni me zallorët*". Është fjala për kaçakët trima të Mokrës e të Gorës, që u dalin në mbrojtje fshatarëve ngaqë nuk i paguajnë xhelepe hyqymetit dhe u kundërvihen zullumeve të bejlerëve të Velçanit e të Kaprosheve. Autori, për ta dhënë këtë, ka gjetur një mënyrë origjinale. Nuk merret me luftën e trimëritë e Zallorëve, por i përshkruan ata në një situatë jo të zakonshme të jetës së tyre plot peripecira: tregon se si u takuan kaçakët me Ndonin, këngëtarin me nam të krahinës! E gjithë idea është kjo: pas natyrës së ashpër të kaçakëve fshihet një zemër e ndjeshme, një shpirt i madh fisnik! Takimi me Ndonin i zbërthen ata: dëgjojnë këngët për trimat si Isuf Qosja e Xhafer Këmbëpula dhe dalëngadalë u lëshohen emocioneve. Kuteli, ky vrejtes i hollë, gjen rast të japë botën e brendshme të kaçakëve, humanizmin e tyre, ndjenjat e mendimet që u zgjon kënga. Rol të veçantë merr figura e Ndonit, që, me zërin dhe përkushtimin e tij pas këngës, derdh në zemrat e Zallorëve optimizëm dhe forcë. Procedura që ndjek autori për zbulimin dhe individualizimin e personazheve është dialogu, një dialog që përftohet nga situatat, në përshtatje me nivelin dhe pozitën e tyre shoqërore, me karakterin e secilit. Në rrëfim janë gërshetuar paraqitja realiste me frymë romantike, notat epike me ato lirike, tonet e forta me ato të buta. Mbi bazën e antitezave dhe dritëhijeve, të dhëna përmes detajeve psikologjike dhe rrethanave shoqërore, rrëfimi tingëllon bindës, i vërtetë e tepër njerëzor.

Me fatin e njerëzve të paligjshëm, të hapsanikëve, (të burgosurve), shokë të kaçakëve, është thurur rrëfimi "*Natë vjeshte të tretë*". Në qendër të tij është gjyshi, një furrxhi që punon për lëvizjen kombëtare në një nga qytetet e jugut. Patriot e punëtor, trim e zemërbardhë, ai përfaqëson vegjëlinë e qytetit, të lidhur me luftën për lirinë e atdheut. Para lexuesit kalojnë njerëz e zhvillohen ngjarje nga më të ndryshmet, të cilat përshkruhen nga pozita e psikologjia e një fëmije. Të perceptuara e të rrëfyera prej tij, të mbushura plot nostalgji për kohën

e fëmijërisë, ato janë dhënë me ngjyra idilike e me nota të një humanizmi pannjerëzor, të pleksura me një varg besëtytnish. Por këto nuk arrijnë të cenojnë atmosferën plot kolorit të kohës, frymën e sinqeritetit, psikologjinë fëminore mbi të cilën ngrihet rrëfimi.

Te Mitrush Kuteli, në periudhën e paraçlirimit, do të ndihet synimi për të përfshirë dhe tablo të realitetit bashkëkohor të fshatit shqiptar. Por kjo gjë nuk ishte e lehtë për të. Mërgimi i gjatë, mosnjohja drejtpërdrejt e proceseve që ndodhën në fshatin tonë gjatë Pavarësisë e pengonin shkrimtarin për ta bërë këtë. Rrëfimet e dëgjuara, kujtimet e fëmijërisë, dëshmitë e shkëputura, jehona e ngjarjeve nuk mjaftonin për të krijuar tablonë e plotë të fshatit shqiptar të kohës. Fshati ynë tani nuk është më ai Rilindjes. Qenë krijuar rrethana të tjera, me procese e probleme që ndryshonin nga e kaluara. Në librin “*Ago Jakupi*”, Kuteli do të botonte rrëfime me këtë temë, po të përmasave të ngushta sociale, sado që në thelb ngrinin probleme jetike të fshatit tonë.

Rrëfimi “*Qetësi përpara fërtyme*” është kuptimplotë për sa i takon evoluimit të botëkuptimit të shkrimtarit. I njëjti rrëfim na paraqitet në dy variante: njëri i shkruar para Çlirimit, me një gamë ideore dhe pasqyruese të ngushtë dhe tjetri në natyrën dhe përmasat e një veprë të plotë realiste. Merita kryesore e rrëfimit të përpunuar qëndron në faktin se autori ka mundur të pasqyrojë me vërtetësi gjendjen shpirtërore të fshatarësisë sonë në kohën e Pavarësisë, zhgënjimin e saj të thellë dhe konfliktin e përhershëm me bejlerët. Si asnjëherë ai e jep masën e fshatarësisë si një masë që shtypet po dhe zien përbrenda nga urrejtja klasore. Burimi i kësaj gjendjeje të rëndë mbetet gjithnjë problemi i pazgjidhur agrar.

Të gjitha këto ide e konstatime kanë gjetur në rrëfim një pasqyrim të fuqishëm ideoartistik. Fshati është paraqitur përmes dy forcave kundërshtare: nga njëra anë janë fshatarët si, Dani, Asllani, Xha Dalipi etj dhe nga ana tjetër, bejlerët e agallarët si, Myrto beu, Ago Zylali etj. Tregimi ka një shtrirje të gjerë dhe në të veprojnë shumë personazhe, por idetë e tij i mbartin Dani e Ago Zylali, si figurat më përfaqësuese. Në qoftë se i pari është fshatari i shtypur, që e ndjen së brendshmi pakënaqësinë e klasës së vet dhe flet për nevojën e luftës për drejtësi, i dyti është fshatari i pasur, përfaqësues i parësisë fshatare që shtyp njerëzit e tokës. Natyra e këtij të fundit si shfrytëzues, cinizmi dhe imoraliteti, dalin në raport me Danin, i cili jepet si njeri punëtor e i ndershëm, trim e bujar. Ai mishëron aspiratat e ndjenjat e klasës së tij, bëhet zëdhënës i saj. Kjo paraqitet në një periudhë qetësie në dukje, po që në fakt, është pragu i furtunës së ardhme, të cilën autori ka ditur ta

vizatojë me realizëm dhe emocione të besueshme. “*Qetësi përpara fërtyme*” si tregimi më i gjatë i Kutelit, ka një frymëmarrje të gjerë jetësore, jo vetëm nga linjat dhe moria e personazheve veprues, po dhe nga begatia e fakteve, e detajeve, e situatave. Ai vlon nga nota të fuqishme të pakënaqësisë shoqërore, nga problemet e mprehta, nga ankesat dhe revolta e fshatarëve ndaj taksave e tagrambledhësve, dhjetarëve e taksidarëve. Dendësia e madhe e fakteve dhe linjat i japin veprës disa veti të romanit, por mungesa e një fabule qendrore, mozaiku i ngjarjeve, ritmi i ngadaltë kanë çuar në një kompozicion pak a shumë të shpërndarë, në një lloj fragmentarizimi dhe prolisiteti. Megjithatë, rrëfimi është dëshmi se autori po shkonte drejt një vështrimi e trajtimi më të thellë të temës së fshatit nga pozitativat e një shkrimtari realist.

Në mes rrëfimeve të Kutelit për fshatin, gjejmë dhe syresh që tregojnë për njerëz dhe ngjarje, të cilat nuk trajtojnë drejtpërdrejt problematikën e mprehtë shoqërore dhe gjendjen e rëndë të fshatit tonë të paraçlirimit. Të tillë janë rrëfimet “*Ago Jakupi*”, “*Fije nga jeta e Theofil Kostarit*” dhe “*Fshati im e pi rakinë*”. Ato kanë të përbashkët botën rustike shqiptare me koloritin e saj të fortë, figura e mentalitete tradicionale, aspekte të jetës zakonore dhe të etikës fshatare, peizazhin piktoresk. Veç kësaj, këto rrëfime afrohen me njëri-tjetrin nga notat e ekzaltimit e idealizimit ndaj së kaluarës, nga retrospektiva e trëndafilte e kohëve të shkuara, nga një frymëmarrje nostalgjike. Zakonisht këto rrëfime, që janë më shumë si ekskursionet nëpër kujtime, nuk kanë subjekt dhe shpesh mbahen falë aftësive narrative të autorit dhe lidhjeve asociative si dhe të groteskut popullore të përdorur me mjeshtëri prej tij.

Rrëfimi për Ago Jakupin është një tregim psikologjik për fshatarin shqiptar. Autori ka mundur të depërtojë në thelbin e tij social. Ago Jakupi është tipi i fshatarit, jetën e brendshme të të cilit e përbëjnë ndjenja e pronës dhe ajo e punës. Kuteli tek ky njeri synon të mishërojë shëmbëlltyrën e burrit shqiptar, njeriun me karakter të fortë e me dinjitet, trim e punëtor, të besës e bujar. Del qartë karakteri i tij, por dhe tipi shoqëror që përfaqëson, individualizmi i pronarit dhe dashuria e njeriut të tokës për punën, pa lënë anash besëtytninë dhe një varg konceptesh fataliste. Rrëfimi është ngritur mbi bazën e disa situatave psikologjike. Ago Jakupi na jepet në moshën e pleqërisë, në gjendje meditimi dhe evokimesh, të cilat kthehen në qortime të ndërgegjegjes, në pendesa për egoizmin e tij. Tregohet se si pleqëria e ka bërë Ago Jakupin më human dhe se frika para vdekjes i ka zbutur zemrën. Në këtë rast nxjerr krye koncepti fetar se duhet të bëjë mirë që të gjejë mirë te zoti. Meditimet e

arsyetimet e plakut zbulohen nëpërmjet monologut të brendshëm, një monologu që zhvillohet në sfondin e peizazhit të fshatit dhe të punëve bujqësore të një familjeje fshatare. Edhe “*Fshati im e pi rakinë*” është një nga rrëfimet piktoreske të Kutelit, me ngjyra të forta e me tone gazmore, kushtuar jetës e zakoneve fshatare. Është fjala për një fshat të krahinës së vendlindjes, për të cilin autori merr përsipër të tregojë mbi zakonet e të pirit. Tregimi i tij është i shtruar, i këndshëm, plot humor. Kjo mënyrë rrëfimi është ajo që e mban tregimin, të cilit i mungon fabula. Flitet për fshatin, që s’di tjetër veçse të pijë, një fshat dionisian, thua se prej andej të ketë dalë perëndia e verës. Vepron në të hiperbola, trazuar me një humor plot kripë, ironia e qesëndia fshatare. Problemet dhe hallet e ditës lihen anash dhe vendin e tyre e zënë situata gazmore e skena gastro-nomike, rite zakonore dhe përshkrimi i portreteve të burrave. Vetëm diku stigmatizohen pushtuesit fashistë. Kudo zotëron nostalgjia për jetën fshatare, që, në fakt, është malli i pashuar i autorit të sapokthyer nga mërgimi i gjatë. Megjithatë, rrëfimi është plot optimizëm, me një humor realist dhe tepër i këndshëm.

Me nota të thella malli është gatuar edhe rrëfimi “*Fije nga jeta e Theofil Kostarit*”. Kemi të bëjmë me një evokim autobiografik, thurur me fije kujtimesh nga fëmijëria e autorit. Zbulohet bota e vogël dhe e madhe e kohës së vegjëlisë, përmes një vargu rrëfenjesh, të lidhura nga rrëfimi aq tërheqës i tregimitarit. Shkrimtari është ndalur në një moment psikologjik tepër të goditur, në kohën kur fëmijëria kalon nga jeta ëndërr në jetën e vërtetë. Ky kalim del bukur nga mënyra se si i kujtohen ndodhi të hershme, që kanë të bëjnë me këngën e Çeços e me kapedan Kajo Babjenin, me nënën, me lodrat e me besimet e kota. Të gjitha këto rrjedhin nëpër rrëfenjëza e biseda sa të natyrshme, aq dhe tërheqëse. Fshatin shqiptar e ndjejmë nga mënyra se si jepen mentalitetet e kohës, sidomos kur flitet për etikën dhe statusin patriarkal, për paragjykimet dhe besëtytnitë e njerëzve, që kanë përfshirë dhe botën e fëmijëve. Dhe të gjitha këto të paraqitura në një plan evokues, si një çmallje e papërballueshme e autorit për vendlindjen. Vetëm nga fundi, shkrimtari gjen rast të shprehë urrejtjen ndaj pushtuesve fashistë që dogjën fshatin dhe vranë njerëzit. Natyrisht, kjo i jep rrëfimit një notë të fortë vërtetësie dhe guximi po të marrim parasysh kohën kur u shkrua e u botua.

Në prozën e shkurtër të Kutelit hyjnë, përveç rrëfimeve dhe rrëfenjat, të cilat dallohen nga të parat, qoftë nga brendia dhe fryma popullore, qoftë dhe nga trajta e ndërtimit të tyre. Rrëfenjat si “*Netë marsi*”, “*Netë gushti*” apo akoma më shumë “*Hanet e karvanet*”,

“*Lugetërit e fshatit tonë*”, “*Natë muaji maj*” etj. janë shkruar mbi motive folklorike e subjekte mitologjike. Ato përshkohen nga fryma e baladave dhe nga mënyra e thurjes dhe e të treguarit janë tipike për narracionin popullor. Disa prej tyre trajtojnë motive patriotike, duke evokuar kohëra legjendare heroike dhe figura të forta trimash, me theksa epikë, që qëndrojnë në mes të gojëdhënës e historisë. Të tillë personazhe të skalitur janë plaka Bubulinë dhe Kostandini (“*Natë marsi*”), ose ajo e Nikollë Branës nga Mokra malore (“*Natë gushti*”). Por me gjithë vlerat që kanë këto tregime, në disa prej tyre, autori tërhiqet aq tepër pas ngjarjeve e figurave legjendare, lëshohet aq shumë pas dëshirës për të rrëfyer mbi gjithë sa ka dëgjuar nga goja e popullit, sa anashkalon idetë domethënëse ose bie në misticizëm, kur flet për disa besëtytni e paragjykime popullore. Në raste të tjera, i joshur nga magjia e fjalës dhe e rrëfimit popullor, autori bie në një farë natyralizmi dhe lë mënjanë qëllimin e asaj që do të tregojë. Kështu, duke pranuar çdo gjë nga mentaliteti i popullit, ai fut në rrëfenjëzat, po dhe në ndonjë rrëfim edhe besëtytni, paragjykime, anakronizma, besime të kota mbi qeniet e mbinatyrshme etj.

Rrëfimet më të mira të Kutelit u takojnë atyre krijimeve të shquara të letërsisë sonë, të cilave lexuesi mund t’u kthehet e rikthehet me dëshirë e ëndje të madhe. Kjo vjen ngaqë nëpër to rrjedhin burime të jetës së gjallë të popullit, ndihen zëra dhe flakërojnë ngjyrat e saj. Kuteli, duke krijuar një tip të ri tregimi në prozën tonë, dëshmoi dhe provoi dhe një herë forcën dhe bukurinë e fjalës shqipe, mundësitë e saj të mëdha shprehëse, aftësitë ndërtuese e krijuese. Të gjitha këto e bëjnë Mitrush Kutelin një nga mjeshtrit virtuozë të tregimit shqiptar.

*

*

*

Vepra e gjerë letrare e Mitrush Kutelit përbën, pa dyshim, një nga përvojat artistike më të vyera dhe më interesante të prozës sonë. Një përvojë origjinale, që mban vulën e një personaliteti të spikatur krijues e që meriton të njihet e të studiohet seriozisht.

Njohja dhe studimi i këtij individualiteti artistik kërkon doemos që të depërtohet në hapësirat e artit të tij, të hyhet në laboratorin e punës së shkrimtarit, të zbulohen të fshehtat e mjeshtërisë së rrëfimit. Pa hetuar e studiuar nga afër këto, nuk mund të përcaktohen si duhet tiparet origjinale të artit kutelian, të dalë i qartë vokacioni që ai përfaqëson në letërsinë tonë.

Në radhë të parë, duhet thënë se Kuteli është nga ata shkrimtarë që tërheq vëmendjen për identitetin e theksuar kombëtar, për një imazh të gjallë shqiptar. E themi këtë, sepse shkalla e karakterit kombëtar në bashkësinë e një letërsie nuk është e njëjtë për të gjithë autorët dhe se ajo në varësi prej tyre merr shprehje të ndryshme. Ka shkrimtarë, vepra e të cilëve dallohet për fizionominë kombëtare më të qartë e më të përcaktuar, e ç'është më e rëndësishmja, paraqitet me nivel më të lartë artistik se të tjerët. Kuteli u takon këtyre të fundit, veçanërisht me rrëfimet e tij, ku ka gjetur shprehje të larta letrare thelbi etnokombëtar i popullit tonë. E kur themi kështu kemi parasysh tiparet e qenësishme të shqiptarit, të jetës e të historisë së tij, të mendësisë dhe të filozofisë popullore, të botës shpirtërore e të konstitucionit psikik. E vështruar më gjerë, vepra e Kutelit në sfondin e përgjithshëm të jetës dhe halleve njerëzore i ngjan një afresku tipik shqiptar.

Autenticiteti kombëtar në krijimtarinë e shkrimtarit tonë, është i gjithanshëm, pasi rrok disa nga sferat më të rëndësishme të botës shqiptare e në radhë të parë të fshatarësisë, si bartësja kryesore e tipareve e vlerave të etnosit tonë. Ato nuk kanë të bëjnë me shfaqje të jashtme, nuk kanë ngjyrimë piktoreske, po me koncepte themelore mbi jetën dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore, mbi kategoritë filozofike dhe juridike, etike dhe estetike. Të gjitha këtyre Kuteli është përpjekur t'u japë vend në veprën e tij dhe ta bëjë këtë nga një pozitë e përparuar, nga pozita e fshatarësisë dhe e vegjëlisë përgjithësisht. Prej këndeje është përfutur universi letrar kutelian, me galerinë e tipeve shqiptare, karakteri i tyre me psikologji e mendësi autentike, me jetën e vet zakonore, me mënyrën e të menduarit e të jetuarit, me mjedise karakteristike dhe peizazh të mirëfilltë shqiptar, me një gjuhë sa të veçantë, aq edhe universale.

Vepra e Kutelit është e mbrytur më një frymëmarrje të gjerë popullore. Vetë autori pohon se ushqimi i tij i përhershëm ka qenë *"piksëpari folklori dhe përsëri folklori"*, se ai është gatuar që për së vogli me gojëdhënat, me rrëfimet e këngët e popullit dhe kanë qenë këto përcaktuese në formimin e tij si shkrimtar. Gjithë sa fitoi më vonë nga leximi i klasikëve shqiptarë dhe i atyre botërorë, e pasuruan dhe e kualifikuan më tej, por themeli mbeti gjithnjë krijimtaria popullore. Prandaj dhe veprat e tij do të kenë tharmin e kësaj krijimtarie e do të thuren me indin e mjetet e saj shprehëse karakteristike.

Tipike për karakterin dhe frymën e theksuar popullore të krijimtarisë së Kutelit janë rrëfimet e tij. Autori nuk nguron të tregojë se ç'rrugë dhe procedim ideoartistik ka ndjekur për krijimin e tyre. Ai është

nisur kurdoherë nga realiteti i drejtpërdrejtë, nga ngjarje të përjetuara e të dëgjuaara prej popullit, nga njerëz dhe mjedise konkrete e të vërtetë. “*Rrëfimet e mia – shkruan Kuteli, - janë reflektim i tregimeve të pleqve ...*”³. Kjo tregon se ai s’ka pas nevojë të shpikë e të fantazojë e aq më tepër të mistifikojë. Përjetimi i thellë i realitetit popullor, shkalla e lartë emocionale që ka zgjuar materiali jetësor te shkrimtari, aftësia reflektuese dhe interpretuese, sensi i hollë i artit dhe bagazhi i pasur gjuhësor, të gjitha këto i kanë shndërruar rrëfimet e popullit në një rrëfim të mirëfilltë letrar.

Puna e autorit me rrëfimet, e hetuar nga afër, tregon se sa i vështirë dhe i mundimshëm ka qenë procesi i krijimit të tyre. Shkrimtar me ndërgjegje të lartë artistike, përherë i pakënaqur nga vetja, martir i punës, Kuteli ka përballuar me sukses të gjitha detyrat komplekse që nxjerr ky lloj i veçantë i prozës tregimtare. Këto dhe volumi i gjerë i tërë veprës së tij letrare janë, siç pohon vetë – fryt i “*një jete pune, punë mundimesh të mëdha*”⁴, sepse ishte në natyrën e një artisti si Kuteli përpunimi, përsosja e vazhdueshme e çdo vepre, si një ligj i detyruar, të cilit ai nuk iu shmang asnjëherë. Duke pasur “*mbi kokë mallkimin e madh të paqetësisë*”, shqetësimin dhe përgjegjësinë e përherëshme të artistit të vërtetë, Kuteli do t’i ripunonte shkrimet 5-6-7 herë, i nisur nga bindja se “*Në art rruga ndaj së thjeshtës shkon shpesh nëpër të ndërlikuarën, të cilën punonjësi i artit duhet ta hedhë poshtë ashtu siç hedh bujku kashtën dhe ruan drithin. Dhe kjo kërkon shumë punë, kështu që më e mira të zëvendojë më të mirën*”⁵.

Kuteli si artist nga fillimi e deri në fund të punës së tij u nis përherë nga e vërteta dhe synoi drejt të vërtetës. E kuptuar dhe e interpretuar teorikisht, kjo do të thotë se shkrimtari u përpoq të ecë nëpër rrugën e realizmit. Mirëpo rruga për te realizmi në rastin e Kutelit, duhet parë në një rrafsh më të gjerë, varur e pleksur nga faktorë letrarë e jashtëletrarë dhe të shtrirë në dy epoka historike.

Realizmi te Kuteli do të jetë shfaqja kryesore në prozën me temë aktuale, ai do të spikasë sa herë që autori do të kthejë sytë nga koha e tij. Tematika sociale dhe trajtimi i saj me vërtetësi, konceptimi i jetës përgjithësisht nga pozita e vegjëlisë e çojnë Kutelin në realizëm. Tek ai

³ Letër V. Balës, 15 gusht 1965, dorëshkrim.

⁴ *Po aty.*

⁵ *Po aty.*

do të ndodhë ajo që thotë Gorki se në krijimtarinë e talenteve të fuqishme realizmi gërshetohet e bashkohet me romantizmin.

Falë një metode të këtillë artistike, Kuteli arriti të krijojë karaktere dhe tipa shoqërorë me vlera përgjithësuere. Heroi kryesor i veprës së tij është fshatari shqiptar, i lidhur me tokën, punëtor dhe luftëtar, armik i çdo robërie kombëtare e shoqërore, luftëtar kundër padrejtësive, njeri i virtytshëm dhe realist, i mençur dhe trim. Por, nga ana tjetër, shkrimtari nuk ka munguar ta nxjerrë dhe të veçuar, lakmitar pas pronës, me besëtytni e paragjykime etj. Të tillë janë figura trimash e kaçakësh si Malush Katunishti, Sefedini e Xhezairi, Guri, xha Brahua, Zallorët, Dani e Ndoni e plot të tjerë, siç janë dhe personazhet femërore të Marës, teto Ngjelinës, Fijes etj.

S'ka dyshim se Kuteli është nga ata shkrimtarë të periudhës së Pavarësisë që ndihmoi për t'i hapur rrugë të gjerë e për ta konsoliduar realizmin në letërsinë tonë. Dihet se proza do të kalonte nëpër një rrugë të mundimshme nga romantizmi në realizëm dhe kjo, jo vetëm për shkak të traditës së fortë romantike, por dhe të rrethanave historike dhe të prapambetjes së shoqërisë shqiptare. Në këto kushte, letërsia, e sidomos proza, detyrohej të anonte e flirtonte me letërsinë sentimentaliste. Do të ishin fryma dhe format e kësaj të fundit që do të ndiheshim më shumë në prozë. Në disa pikëpamje, sentimentalizmi mund të merret dhe si stadi femënor i realizmit në një letërsi si e jona. Dhe që të kapërcehej kjo gjendje, lypej jo vetëm ngritja e nivelit të përgjithshëm të letërsisë, por dhe talente të fuqishme. Për këtë do të ndihmonte me sukses Migjeni, por ndihmesë do të jepte edhe Kuteli me rrëfimet më të mira. Disa nga problemet shoqërore që ngriti, si dhe krijimi i karaktereve të fuqishme dhe mjedisëve të besueshme e bëjnë prozën e tij t'i takojë letërsisë realiste. Aq më tepër, këtë mund ta themi për rrëfimet e viteve të fundit, që u ripunuan nga pozita të avancuara dhe me koncepte të reja ideestetike.

Por, në tërësi, proza e Kutelit, e parë në vështrim retrospektiv, në vijat e saj të përgjithshme paraqitet, siç është pohuar me të drejtë, “*një prozë realiste, me theks të dukshëm romantik*”⁶. Ky tipar i dytë do të ndjehet kryesisht në evokimin e së kaluarës, në trajtimin e figurave legjendare dhe bëmave heroike, në poetizimin e jetës zakonore dhe të natyrës shqiptare. Mjeshtëria e lartë artistike, mund të vërehet në disa nga

⁶ *Historia e letërsisë shqiptare*, (Botim i Akademisë së Shkencave), Tiranë, 1983, f. 641.

aspektet e punës së tij prej prozatori. Krijimi kutelian qëndron mes frymës lirike dhe trajtave epike, ku shpesh zotëron e para, sepse, siç thotë dhe autori, “*për të rrëfyer duhet një fluid lirik*”⁷. Në këtë pikëpamje, na duket i drejtë përcaktimi se rrëfimet e këtij shkrimtari janë “*krijime me një nënshtrat të fuqishëm lirik, i cili, aty-këtu, del në sipërfaqe për t’u përthithur me elementët zotëruar epikë dramatikë*”⁸. Në tërësi, mund të themi se rrëfimet përbëjnë një pleksje të toneve të forta epike me notat e buta lirike dhe notat humoristike, si dhe të konceptimit realist me përfytyrime romantike brenda natyrës popullore.

Kuteli thotë se për rrëfimet e tij nuk ndoqi asnjë model të huaj, po u mbështet në traditën e pasur të prozës sonë popullore, fryma dhe poetika e saj u bënë për shkrimtarin modeli më i mirë. Kjo mënyrë të treguari dhe të endure i dha mundësi atij të ngërthente një lëndë sa më të pasur nga jeta e historia, por dhe të realizonte edhe ato synime themelore që kërkon tipizimi dhe individualizimi artistik i personazheve, thurja e konflikteve, ndërtimi i situatave, përshkrimi i mjediseve, shfrytëzimi i detajit etj.

Poetika e rrëfimeve të Kutelit është vërtet poetika e rrëfimit popullor, veçse e përpunuar artisikisht, e kthyer në një mekanizëm të të strukturuarit artistik. Në rrëfimet e Kutelit, ashtu siç ndodh dhe në rrëfimin popullor, një rol të rëndësishëm luan figura e rrëfimtari. Ai krijon raporte të caktuara me dëgjuesin, me kohën dhe me hapësirën dhe kthehet në personazh unik i gjithë prozës së tij tregimtare. Rrëfimtari dhe autori shpesh shkrihen në një ose zëvendësojnë njëri-tjetrin.

Funksioni i rrëfimtari të Kutelit është i gjithanshëm. Me anë të tij bëhet zbulimi i tipit dhe karakterit të personazheve, përshkrimi i situatave psikologjike dhe i gjendjeve shpirtërore, shtjellimi i konflikteve. Nga mënyra si ai tregon ngjarjen, si zbulon figurën, çfarë thotë e çfarë lë pa thënë, detaji që përdor, të gjitha këto i shërbejnë strukturimit artistik të veprës. Nga ana tjetër, në këtë lloj tregimi merr rëndësi të veçantë raporti i rrëfimtari me lexuesin, pasi ai synon të jetë më i natyrshëm e komunikues e të krijojë lidhje të drejtpërdrejta mbi një bazë të përligjur psikologjike. Në këtë mes, fjala ka një peshë të madhe semantike dhe emocionale dhe artikulumit i saj gjatë rrëfimit varet në një shkallë të madhe nga ritmi i të treguarit.

⁷ M. Kuteli, *Kujtesë*, f. 16.

⁸ Sali Bashota, *Modele të veçanta të një shkrimi*, Rilinda, 14.1.1989.

Elementet e poetikës në rrëfimet e Kutelit duhen parë dhe në veçorinë e subjektit e të fabulës, në pasurinë e detajit, në variacionet e ligjërit, në origjinalitetin e kompozicionit. Fabulat kuteliane paraqiten në dukje të thjeshta, pa ndërlikime e me një zhvillim të natyrshëm, por rrokjin shumë anë të realitetit, duke depërtuar në thellësi e duke u shtrirë në hapësirë e në kohë. Në qendër merren ngjarje të rëndësishme, çaste kulmore të jetës dhe ndërthuren konflikte të ashpra me tension dramatik. Përveç kësaj, Kuteli, në prozën e tij, udhëhiqet nga sqarimi retrospektiv i evokimit të kohës së fabulës dhe kohës së veprimit. Kjo do të thotë se largësia kohore është veçori e poetikës së tij. Një gjë e tillë vërehet qartë nga mënyra e të perceptuarit të ngjarjeve, nga sistemi i ndërtimit të personazheve dhe raportit midis tyre, si dhe nga dialogu e monologu dhe, veçanërisht, nga pikëvështrimi i rrëfimit.

Në disa rrëfime subjekti përfshin brendapërbrenda ngjarje dhe episode, personazhe dhe mjedise, që i bashkon filli i rrëfimit të rrëfimtariëve ose autorit. Disa herë kemi ngjarje të lidhura zinxhir, apo brenda tregimit thuren rrëfenjëza për të bërë pastaj kalimet përmes disa njeve lidhëse. Kjo s'duhet parë si dobësi kompozicionale, por si pasojë e ndikimit të rrëfimit popullor.

Në rrëfimin kutelian detaji është një nga mjetet më efektive të procedurës artistike dhe si i tillë paraqitet i shumëllojshëm. Me vetitë e tij artistike, detaji i shërben drejtpërdrejt procesit të individualizimit e të tipizimit, konkretizon natyrën e fenomenit në përputhje me logjikën psikologjike e artistike.

Ashtu si te tregimtarët e tjerë dhe te rrëfimet e Kutelit gjejmë edhe gjykimin e rrëfyesit mbi atë që tregon, siç gjejmë dhe përshkrimin, dialogun e monologun. Por merita e autorit tonë, në këtë rast, është se këto forma e mjete të njohura i ka përdorur e shfrytëzuar me origjinalitet e me mjeshtëri të lartë artistike. Të treguarit e Kutelit është sa analitik aq edhe sintetik, i shprehur zakonisht me ritmin e kadencën e bisedës, me një dinamikë të brendshme. Mënyra si tregon e rrëfen jo vetëm pasqyron e vizaton, por bën të përftohen veprime e lëvizje.

Shprehja më e plotë e mënyrës së rrëfimit të Kutelit janë përshkrimet. Përshkrimi tek ai është i fuqishëm, karakterizues dhe i harmonishëm. Autori e përdor si për të dhënë situatë e mjedise, ngjarje dhe ndeshje, por ai merr vlera të veçanta kur është fjala për peizazhin e portretin. Në këtë vështrim, Kuteli paraqitet mjeshtër i shquar. Mjeshtër i pikturimit të natyrës dhe mjeshtër i fizionomisë njerëzore, peizazhist e portretist i dorës së parë. Prandaj, me të drejtë mund ta quanim poet i

shpirtit shqiptar dhe këngëtar i natyrës shqiptare. Në përshkrimet e natyrës, proza tek ai kthehet në poezi dhe faqe të tilla, që hasen me dhjetëra në rrëfimet e tij, tingëllojnë si proza poetike të denja për çdo antologji. Përshkrimet e Kutelit janë copa të gjalla jete, plot nerv e lëvizje, krejt të vetvetishme, mbrujtur me gjendje shpirtërore dhe mendim fisnik, me larmi figurative e nota të fuqishme emocionale.

Pjesë e pandarë e prozës së Kutelit janë dhe dialogu me monologun, të cilët së bashku me përshkrimin ndërtojnë veprën. Ato shfaqen në situata të caktuara, si një nga burimet e informacionit, por akoma më shumë, me funksion tipizues e individualizues. Mënyra e thurjes së tyre, veçoritë gjuhësore, leksiku dhe ndërtimi sintaktik i bëjnë ato që, objektivisht, të bartin psikologjinë e personazheve, botëkuptimin dhe mentalitetin, shkallën e kulturës dhe temperamentin. Në qoftë se dialogu qëndron brenda kufijve të gjuhës së bisedës, është i gjallë e i shtruar në varësi nga rrethanat, ruan ritmin e saj, monologu ka nëntekst të qartë, rrjedh pa artifice dhe në harmoni me komponentët e tjerë. Në të dy rastet ndihet qëndrimi ideoemocional i autorit dhe është i pranishëm tendencioziteti i tij.

Poetika e prozës së Kutelit nuk mund të kuptohet pa poetikën e kompozicionit të rrëfimeve. Zakonisht ato janë në varësi nga rrëfimtari dhe rrëfimtari luan rol organizues në kompozicionin e tregimit. Ai paraqet hyrjen, subjektin, ka fillin e intrigës, bën zgjidhjen. Ekzistojnë marrëdhënie të brendshme të vazhdueshme në mes rrëfimitarit, heroit dhe lexuesit dhe janë këto që përcaktojnë karakterin e ndërtimit të tregimeve. Ato mund të përputhen ose mund të diferencohen nga njëri-tjetri. Dhe janë këto marrëdhënie që u japin larushi trajtash rrëfimeve. Po pavarësisht nga kjo, rrëfimet në përgjithësi kanë një gjë të përbashkët: autori përpara se të tregojë, e përgatit lexuesin. Është ai që ndjell atmosferën, përgatit mjedisin dhe njerëzit që do të dëgjojnë e pastaj i fut në labirintet e rrëfimit.

Subjekti i rrëfimeve të Kutelit ndërtohet në mënyrë të atillë që të rrokë gjithë jetën e heroit ose një pjesë të saj. Brenda subjektit ai integron organikisht, si komponent të përgjithshëm edhe digresione të ndryshme, të gërshetuara këto me përshkrimin dhe dialogun. Në këtë pikëpamje gjejmë struktura origjinale, si shprehje të poetikës së autorit.

S'ka dyshim se thesari më i çmuar që na ka lënë Kuteli si shkrimtar është gjuha. Me të drejtë, ai cilësohet një nga mjeshtrit e mëdhenj të saj, një nga stilistët e mbarë letërsisë shqiptare. Adhures dhe ndjekës besnik i gjuhës së rilindësve, i ushqyer në gurrën e pasur të të

folmes së vendlindjes, Kuteli do të formohet si shkrimtar sa në shkollën e gjuhës shqipe, aq edhe në atë të jetës shqiptare. Konceptet e tij për gjuhën amtare, janë jo vetëm ato të një atdhetari të flaktë, që e sheh atë si një nga tiparet e qenësishme të kombit dhe pasuri të madhe shpirtërore të popullit, po dhe të një artisti të shquar që i përkushtohet asaj shpirtërisht, intelektualisht e fizikisht. Kuteli mahnitet pas forcës e bukurisë së gjuhës shqipe, pasurive dhe hireve të saj, e shenjtëron dhe e kthen në kult. I ndërgjegjshëm për vlerat dhe rolin e gjuhës në jetën dhe kulturën e kombit të vet, ai punon pa u lodhur për t'i njohur e përvetësuar thesaret e saj, për të depërtuar në hapësirat dhe skajet e saj, për të pushtuar majat dhe thellësitë, por dhe për t'u kredhur në shpirtin e fjalës shqipe. Vetëm kështu Kuteli arriti të krijojë veprën e vet letrare. Puna e tij e nisur në vitet 20-30 të shekullit të shkuar, bën pjesë në përpjekjet madhore të atyre prozatorëve, që e ngritën gjuhën shqipe dhe në këtë gjini në nivelin e një gjuhe me të vërtetë artistike me vlera të reja estetike dhe ideoemocionale. Kjo ishte një çështje themelore për prozën tonë, sepse ajo s'mund të bënte atë kapërcim cilësor që bëri, pa iu shmangur gjuhës retorike, skematike e sentimentaliste që zotëronte përgjithësisht.

Duke e studiuar nga afër gjuhën e Kutelit, do të vëmë re se ajo përbën një nga krerët më të pasur e më me vlerë të prozës sonë të traditës dhe jo vetëm të asaj. Ajo dallohet si një gjuhë e mbrujtur me jetë të gjallë, me forcë të brendshme, me begati dhe bukuri të madhe. Veç kësaj, gjuha e Kutelit karakterizohet nga cilësi të larta të ligjërimit artistik, jo vetëm për nga leksiku i pasur dhe i pastër, por dhe nga fryma ngjizëse, nga aftësitë analitike e sintetike, nga vetitë ndërtuese, të një sintakse thjeshtë shqip. Vitaliteti i saj duket dhe nga pasuria figurative e muzikore, nga nuancat e holla stilistike.

Kuteli është një nga stilistët që i ka të paktë shokët në letërsinë tonë, një stilist me individualitet, me tipare krejtësisht të vetat. Ai u krijua si i tillë duke përvetësuar me themel gjuhën e popullit, duke iu përmbajtur me konsekuencë ligjeve të rrëfimit popullor. I ndjeshëm në një shkallë të lartë ndaj gjuhës, me sensin e një artisti të hollë, me një kulturë të gjerë letrare dhe me synime ideoartistike të ndërgjegjshme, ai diti të krijojë një stil origjinal. Stili i tij ligjëron shqip, është sa lirik aq edhe epik, elegant dhe me ngjyime poetike, i pasur me frazeologji dhe i nuancuar. Ai paraqitet sa i qetë e i shtruar, aq edhe i shqetësuar dhe shpërthyes, sa i ndjeshëm aq edhe lakonik, por gjithnjë plazmueshëm dhe me natyrë rrëfimtare. Fraza e tij rrjedh natyrshëm dhe me një harmoni të brendshme, me kadenca nga më të ndryshmet. Variacionet që merr

ligjërimi artistik në gjuhën e Kutelit janë të pasura dhe të shumëllojshme, ato ndërrojnë në përshtatje me brendinë ideore, me psikologjinë e personazheve dhe tensionin dramatik.

Marrëdhëniet e Kutelit me folklorin dhe, përgjithësisht, me krijimtarinë popullore janë të gjithanshme, të thella e të frytshme. Ndoshta, askush në prozën tonë të traditës nuk diti dhe nuk arriti të përfitojë prej tyre atë shkallë të lartë e në përmasa aq të gjera sa bëri Kuteli. Pa lënë anash traditën e letërsisë sonë kombëtare, adhures i Naimit e i Nolit, po dhe njohës i thellë i letërsisë së huaj, Kuteli në mënyrë të ndërgjegjshme, u mbështet në radhë të parë në modelet dhe përvojën artistike të popullit dhe i dha fizionominë e tij. Kjo ndodhi, se në këtë proces të gjatë e të vështirë, shkrimtari ynë bëri për vete shpirtin dhe frymën krijuese të popullit, përvetësoi ligjet estetike dhe etike të rrëfimit, mekanizmin e brendshëm të të treguarit dhe të gjitha këto arriti t'i japë brenda natyrës gjuhësore të fjalës së popullit.

Pesha e Kutelit në letërsinë tonë të traditës e veçanërisht në prozën e saj nuk është vetëm ajo e një talenti të shquar, por edhe e një fenomeni që rrezatoi dhe jashtë vetes. Me individualitetin e tij artistik, si krijues i një tipi të veçantë të tregimit, me stilin dhe gjuhën që përdori, ai hapi një brazdë të re në prozën tonë tregimtare, krijoi një shkollë të tregimit shqiptar. Nëpër të do të kalonin disa nga tregimtarët e brezave të mëvonshëm si, J. Xoxa, N. Prifti, A. Kondo, S. Andoni etj.

Trashëgimia letrare e Kutelit është e gjerë, e pasur dhe e fuqishme. Në të gjejmë, po të shprehemi me fjalët e autorit, “*botën e vogël shqiptare, që pasqyron botën e madhe*”. Është toka dhe qielli ynë, janë malet dhe fushat tona, ndrisin ditët dhe netët shqiptare, janë zërat e ngjyrat e tyre. Në këtë botë jeton e mbijeton njeriu shqiptar, të cilin shkrimtari e ka dhënë përmes rrëfimeve të tij me fizionomi e relief të qartë shpirtëror e fizik.

Summary

THE GREAT NARRATOR MITRUSH KUTELI

The foregoing paper is an extract from the monograph of the same title by Nasho Jorgaqi. It is focused on the narrative prose of Mitrush Kuteli, regarded as one of the founders of modern Albanian narrative during the 1920s to the 1930s of the past century.

Literary contribution of Kuteli has been considered firstly in the large context of the Albanian literature, especially in comparison with the works of other representative figures of short narrative prose, such as Migjeni, Ernest Koliqi, Nonda Bulka etc. Their thematic and artistic contribution made the historical change in Albanian narrative, developed until then in the frame of a didactic and moralistic one.

Most of the paper deals with detailed analysis of all the short narrative prose of Kuteli. There are about thirty stories which are considered both from their content and their artistic means and proceedings. A series of original qualities of Kutelian prose are drawn and evident by the scholar. The latter tries to prove that Mitrush Kuteli founded his own school in the Albanian narrative prose, but it remains to be further examined and verified by other scholars who are trying to deeply penetrate into the creative laboratory of the outstanding narrative master.

